



BULETIN INFORMATIV

JANAR - MARS 2025

Znj. Gerta Lubonja emërohet Kryetar i Entit Rregullator të Ujit

Në 26 shkurt, Këshilli i Ministrave emëroi Kryetarin e Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura Znj. Gerta Lubonja. Me një përvojë të pasur në menaxhimin e burimeve ujore, me vizionin dhe përkushtimin e saj, Znj. Lubonja do të udhëheqë ERRU në përmirësimin e politikave rregullatore, avancimin e reformës në sektorin e ujit dhe garantimin e një shërbimi cilësor për të gjithë qytetarët. Ajo ka mbi 20 vjet përvojë në fushën inxhinierike, menaxhimin e ujërave dhe hartimin e politikave publike në këtë fushë. E diplomuar për Inxhinieri Hidroteknike pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, Znj. Lubonja ka ndjekur specializime të avancuara në Japoni, Austri dhe Turqi, duke thelluar ekspertizën e saj jo vetëm në menaxhimin e ujërave, por edhe në fusha të tjera të lidhura me infrastrukturën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj. Gjatë periudhës 2004–2014, ka qenë e angazhuar në sektorin privat, duke marrë pjesë në hartimin e një sërë projektsh të rëndësishme infrastrukturore. Në vitin 2011 u zgjodh anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës, ku për një mandat 4-vjeçar drejtoi Komisionin e Rregullimit të Territorit, duke kontribuar në zhvillimin urban dhe menaxhimin e qëndrueshëm dhe të integruar të kryeqytetit. Në vitet 2014–2024 ka qenë pjesë e administratës publike, ndërsa gjatë 2014–2018 ka punuar pranë Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, ku ka drejtuar fillimisht Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe më pas në cilësinë e Sekretarit Kombëtar të Ujit. Nga viti 2017- 2024 ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Gjatë angazhimit të saj në këto dy institucione ka luajtur një rol kyç në hartimin e legjislacionit kombëtar për ujërat, përafrimin me “Aquis” të BE, si dhe në zbatimin e konventave e marrëveshjeve evropiane e ndërkombëtare.

PËRMBAJTJA

- EMËROHET KRYETARI I RI I KKRR
- BASHKËPUNIME
- PJESËMARRJA NË SEMINARE
- TRAJNIME



Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë dhe ka përfaqësuar Shqipërinë në aktivitete, takime dhe komisione ndërkufitare. Përveç kontributit të saj institucional, Znj. Lubonja është autore e një sërë publikimesh dhe kumtesash shkencore, të prezantuara në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ndarë kështu përvojën dhe ekspertizën e saj në menaxhimin e ujërave dhe zhvillimin e politikave të qëndrueshme.

BASHKËPUNIME

ERRU merr pjesë në Takimin e 34 të Asamblesë së Përgjithshme të WAREG

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve të Ujit (WAREG), e cila u mbajt më 2-3 prill në #Jūrmala, Letoni. Me një ekip të përfaqësuar nga Znj. Gerta Lubonja, Kryetar i ERRU, mbledhja e 34 e Asamblesë së WAREG solli në tryezën e diskutimit tema kyçe mbi: Rregullimin e shërbimeve të ujit në Evropë; Rëndësinë e Treguesve të Përbashkët të Performancës për rregullatorët e ujit; Përditësimet mbi aktivitetet e organizatës, përfshirë qeverisjen



e WAREG dhe avancimin e politikave në menaxhimin e sektorit të ujit. Pjesëmarrja aktive e ERRU në këtë asamble, të parën për këtë vit, konfirmon angazhimin për të ndjekur dhe kontribuar në zhvillimet më të fundit në sektorin rregullator të ujit në nivel evropian si dhe për të përthithur eksperiencat më të mira.

SEMINARE



Në 13 Mars, Enti Rregullator i Ujit u bë pjesë e seminarit të tretë të projektit të financuar nga BE "Crosswater +" që u zhvillua në Podgoricë/Mal i Zi. ERRU u paraqit në seminar me prezantimin "Reforma në sektorin e ujit: Përmbushja e kornizës rregullatore dhe impakti në performancë". Pjesëmarrësit patën mundësi të shkëmbejnë eksperiencë me institucione dhe kompani nga Mali i Zi, vendet e rajonit dhe Italia mbi: menaxhimin e sektorit UK; humbjet në rrjet; tarifat e ujit dhe sfidat infrastrukturore. Pjesë e programit ishin vizitat në objektet e rrjetit të furnizimit me ujë në bregdetin malazez, që nga burimi "Bolje Sestre", stacionet e pompimit, tunelin hidro-teknik dhe rezervuarin duke ofruar një vështrim të detajuar mbi menaxhimin e burimeve ujore në këtë rajon. Projekti "Crosswater+" synon forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar për një zhvillim të zgjuar dhe të qëndrueshëm të territoreve të përfshira, si pjesë e procesit të para-anëtarësimit të Shqipërisë dhe Malit të Zi në BE. UK Tiranë është një prej përfituesve të këtij projekti.

"Reforma e ujit: Përmbushja e kornizës rregullatore e impakti në performancë", prezantimi në seminarin e "Crosswater"

EVENTET E ARDHSHE

• 23 - 25 Prill

Takim pune ERRU & ARRU,
Shqipëri/Pogradec

14 - 16 Maj

Konferenca Vjetore e
Danubit
Austri/Vjenë

• 18 - 19 Qershor

Asambleja e Përgjithshme e
35-të e WAREG,
Greqi/Athinë

TRAJNIME



ERRU, pjesë e Programit të Qeverisjes së Shërbimeve në Timisoara, Rumani

Përfaqësues të autoriteteve, rregullatorë dhe operatorë të ujësjellës-kanalizimeve nga 6 shtete të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, u mbledhën në Timisoara, Rumani për 5 ditë trajnimi (17-21 shkurt) për të ndarë praktikat më të mira të qeverisjes në fushën e ujërave dhe për forcimin e bashkëpunimit mes autoriteteve dhe operatorëve të shërbimeve UK. Diskutimet u fokusuan në rregullimin ekonomik dhe tarifat, menaxhimin financiar dhe atë të aseteve, strategjitë për rritjen e efikasitetit të kostove, metodologjinë e tarifave dhe rregulloret specifike të vendeve pjesëmarrëse. Secili delegacion ndau metodat për llogaritjen e tarifave, duke krahasuar mënyrat se si vendosen çmimet e shërbimeve të ujit në nivel evropian. Fokusi kaloi më tej te legjislacioni i BE-së për menaxhimin e ujërave e ndikimi i tij në shoqëri, si dhe zgjidhjet për mbrojtjen e burimeve ujore.



Trajnim për “Planifikimin e Sigurisë së Ujit dhe Menaxhimin e Krizave”

Nga 17-21 mars, ERRU u bë pjesë e trajnimit “Planifikimi i Sigurisë së Ujit dhe Menaxhimi i Krizave”, organizuar nga programi D-LeaP në ambientet e Bankës Botërore në Vjenë. Temat kryesore të trajtuara përfshinë: Bazat e Menaxhimit të Rreziqeve; Manuali i Menaxhimit të Krizave dhe Trajnimi në Menaxhimin e Krizave; Ushtrime praktike për Menaxhimin e Krizave; Planifikimi i Sigurisë së Ujit. Përmes këtij trajnimi synohet fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve të ujit për të përballuar sfidat e menaxhimit të rreziqeve dhe krizave. Zhvillimi i burimeve njerëzore mbetet një nga prioritetet kryesore të punës së ERRU, pasi ndihmon në përmirësimin e qasjeve rregullatore dhe forcimin e kompetencave të stafit për të siguruar menaxhim më të sigurt dhe efikas të shërbimeve.

“Aksesi në financim”, ERRU në seminarin e Programit D-LeaP

Në 4 Shkurt, Enti Rregullator i Ujit (ERRU) u bë pjesë e workshopit të parë të Programit D-LeaP “Aksesi në Financim”, nën organizimin e SHUKALB, në datat 30-31 janar 2025. Aktiviteti, që mbështetet nga Partneriteti i Danubit dhe projekti RCDN+ synon forcimin e menaxhimit financiar të shërbimeve të ujit dhe mundëson rritjen e qëndrueshmërisë financiare për ofruesit e shërbimeve të ujit në nivel kombëtar.

Pjesëmarrës nga shoqëritë ujësjellës kanalizime Sarandë, Berat, Gjirokastrë, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë, së bashku me përfaqësues të ERRU dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime (AKUK), patën mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre mbi financimin e shërbimeve të ujit dhe të diskutojnë praktikat më të mira për përmirësimin e performancës financiare.



Trajnimi i stafit të ERRU është kyç për forcimin e kapaciteteve të këtij institucioni në mbikëqyrjen e shërbimeve të ujit dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët.

